

1 E martë, 10 maj 2022

2 [Paraqitje e mëtejshme]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 11.15

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes dhe mirë se  
7 erdhët të gjithëve brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Znj. Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Lënda KSC-  
10 BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit,  
11 Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Tani do t'u kërkoj palëve që të prezantohen.

14 Do të fillojmë me Zyrën e Prokurorit.

15 Urdhëroni z. Prokuror.

16 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit. Mirëmëngjes të  
17 gjithëve. Alan Tieger dhe Dounia Hattabi përfaqësojmë Zyrën e  
18 Prokurorit në seancën e sotme.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Tani radhën e ka Mbrojtja.

21 Z. Emerson.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes]

23 Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës dhe të gjithë që i ndjekin  
24 këto procedura. Unë jam Ben Emerson. Annie O'Reilly është e  
25 pranishme në sallë të gjyqit dhe të dy përfaqësojmë z. Veseli

1 sot.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Laws

3 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes,  
4 unë jam Simon Laws dhe përfaqësoj viktimat në këtë çështje.  
5 Dhe në sallë është e pranishme përfaqësuesja ime znj.  
6 Radzdiejowska.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti përfaqësues i Zyrës  
8 Administrative.

9 Z. NILSSON: [Përkthim] Unë jam z. Nilsson dhe përfaqësoj  
10 Zyrën Administrative.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E shikoj që z. Veseli ndjek  
12 këtë seancë përmes videolidhjes.

13 Me 3 shtator, ZPS-ja paraqiti kërkesë për ndryshimin e  
14 aktakuzës në përputhje me rregullën 90(1)(b). ZPS-ja  
15 parashtroi tre kategori të ndryshme.

16 Kategoria e parë përmban dy qendra ndalimi në komunën e  
17 Suharekës, në të cilat ose në lidhje me të cilat pjesëtarë të  
18 UÇK-së kryen veprime të përndjekjes, burgosjes ose ndalimit  
19 arbitrar, veprime të tjera çnjerëzore, trajtim mizor, torturë,  
20 vrasje të paligjshme dhe zhdukje me forcë.

21 Kategoria e dytë e ndryshimeve kishte të bënte me dy  
22 incidente të përndjekjes, të vrasjes së paligjshme të kryera  
23 në lidhje me një qendër ndalimi në komunën e Gjilanit dhe me  
24 ndryshimin e kornizës kohore lidhur me këtë qendër ndalimi.

25 Kategoria e tretë përfshinte dy incidente të pjesëmarrjes

1 personale të të akuzuarit në krimet që i ngarkohen.

2 Me 23 dhjetor 2021, nxora vendimin e parë mbi kërkesën e  
3 ZPS-së në të cilin miratova mocionin e Prokurorisë për  
4 ndryshimin e aktakuzës në lidhje me kategorinë e tretë të  
5 ndryshimeve të propozuara, të cilat gjykova se nuk përbënin  
6 akuza të reja.

7 Gjithashtu, konstatova se kategoria e parë dhe e dytë e  
8 ndryshimeve përbënin akuza të reja dhe rrjedhimisht duhet të  
9 shqyrtohen kundrejt standardit të duhur të provës që është  
10 dyshimi i bazuar mirë, në pajtim me rregullën 86(4) të  
11 Rregullores, nën dritën e provave të parashtruara në bazë të  
12 rregullës 86(3) të Rregullores.

13 Palët u urdhëruan të dorëzonin përgjigjet e tyre dhe t'i  
14 përgjigjeshin pyetjes nëse materialin në lidhje me ndryshimet  
15 që përbëjnë akuza të reja mbështet një konstatim për  
16 ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë, sipas rregullës 86(4)  
17 të Rregullores.

18 Me 22 prill 2022, konfirmova ndryshimet e kategorisë së  
19 parë dhe të dytë dhe akuzat që ato përmbajnë të cilat i  
20 ngarkohen të akuzuarit.

21 Gjithashtu urdhërova Prokurorinë që deri të premtën, 29  
22 prill 2022, të parashtronte një aktakuzë të ndryshuar me  
23 ndryshimet e kategorisë së parë dhe të dytë të përfshira në  
24 të.

25 Me 29 prill 2022, Prokurori dorëzoi aktakuzën e

1 ndryshuar, një version konfidencial me më pak redaktime dhe  
2 një version të redaktuar publik të përmbledhjes së provave të  
3 kategorisë së parë dhe versionet e redaktuara konfidenciale  
4 dhe publike të përmbledhjes së provave në lidhje me kategorinë  
5 e dytë të ndryshimeve.

6 Me 2 maj 2022, caktova datën për këtë seancë të  
7 paraqitjes së mëtejshme.

8 Tani më lejoni të shpjegoj qëllimin konkret të paraqitjes  
9 vijuese për nevojat e të akuzuarit dhe atyre që ndjekin  
10 seancën nga galeria për publikun dhe nëpërmjet transmetimit në  
11 internet.

12 Seanca e sotme nuk është gjykim. Në këtë seancë nuk do të  
13 paraqiten as debatohen prova. Qëllimi i kësaj paraqitjeje  
14 vijuese rregullohet me nenin 30 të Ligjit dhe rregullat 90 dhe  
15 92 të Rregullores.

16 Në pajtim me këto dispozita, unë si Gjykatës i Procedurës  
17 Paraprake ja lexoj të akuzuarit akuzat e reja të përfshira në  
18 aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar; konfirmoj nëse i akuzuari  
19 i kupton akuzat e reja; bindem se të drejtat e të akuzuarit,  
20 veçanërisht e drejta e tij për të pasur avokat mbrojtës janë  
21 respektuar; dhe informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga  
22 dita e seancës së sotme ai do të ftohet të vetëdeklarohet  
23 fajtoj ose i pafajshëm në lidhje me secilën akuzë të re të  
24 përfshirë në aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar.

25 Megjithatë, në qoftë se i akuzuari dëshiron ai mund të

1 vetëdeklarohet menjëherë sot në lidhje me fajësinë ose  
2 pafajësinë.

3 Pres nga palët që t'ju përmbahen këtyre pikave të cilat  
4 unë do t'i trajtoj një nga një. Dhe nëse palët dëshirojnë të  
5 diskutojnë ndonjë pikë tjetër që nuk është paraparë  
6 shprehimisht në kuadër të seancës së paraqitjes vijuese,  
7 ftohen që këtë ta bëjnë me anë të parashtrimeve me shkrim.

8 Së pari, z. Veseli, a mund të më konfirmoni se e keni  
9 marrë aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar të datës 29 prill  
10 2022?

11 I AKUZUARI VESELI: [Përmes videolidhjes] Po, e kam marrë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Veseli.

13 Tani do t'i kërkoj Sekretares së Gjykatës t'i lexojë  
14 akuzat e reja sikurse parashikohet në rregullat përkatëse të  
15 Rregullores dhe me Ligj.

16 Urdhëroni znj. Sekretare

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

18 Në aktakuzën e ndryshuar të konfirmuar, Prokurori i  
19 Specializuar shton akuzat e reja në vijim kundër z. Kadri  
20 Veseli:

21 a. Në lidhje me krimet që pretendohen të jenë kryer në  
22 Budakovë dhe Semetishtë të komunës së Suharekës, midis  
23 afërsisht 4 korrikut 1998 dhe shtatorit 1998 dhe më 28 ose 29  
24 prill 1999 ose rreth këtyre datave, në lidhje me të paktën 12  
25 persona:

1 i. Pika 1: Krimi kundër njerëzimit i përndjekjes i  
2 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(h) të Ligjit;

3 ii. Pika 2: Krimi kundër njerëzimit i burgosjes i  
4 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(e) të Ligjit;

5 iii. Pika 3: Krimi i luftës i ndalimit arbitrar i  
6 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit;

7 iv. Pika 4: Krimi kundër njerëzimit i akteve të tjera  
8 çnjerëzore i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(j) të Ligjit;

9 v. Pika 5: Krimi i luftës i trajtimit mizor i  
10 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

11 vi. Pika 6: Krimi kundër njerëzimit i torturës i  
12 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(f) të Ligjit;

13 vii. Pika 7: Krimi i luftës i torturës i ndëshkueshëm në  
14 bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

15 viii. Pika 8: Krimi kundër njerëzimit i vrasjes së  
16 paligjshme i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(a) të Ligjit;

17 ix. Pika 9: Krimi i luftës i vrasjes së paligjshme i  
18 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit; dhe

19 x. Pika 10: Krimi kundër njerëzimit i zhdukjes me  
20 forcë të personave i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(i) të  
21 Ligjit.

22 b. Në lidhje me krimet që pretendohen të jenë kryer në  
23 Gjilan, të komunës së Gjilanit, përsëri në korrik 1999 në  
24 lidhje me të paktën 3 persona:

25 i. Pika 1: Krimi kundër njerëzimit i përndjekjes i

1 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(h) të Ligjit;

2 ii. Pika 2: Krimi kundër njerëzimit i burgosjes i  
3 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(e) të Ligjit;

4 iii. Pika 3: Krimi i luftës i ndalimit arbitrar i  
5 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit;

6 iv. Pika 4: Krimi kundër njerëzimit i akteve të tjera  
7 çnjerëzore i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(j) të Ligjit;

8 v. Pika 5: Krimi i luftës i trajtimit mizor i  
9 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

10 vi. Pika 6: Krimi kundër njerëzimit i torturës i  
11 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(f) të Ligjit;

12 vii. Pika 7: Krimi i luftës i torturës i ndëshkueshëm në  
13 bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

14 viii. Pika 8: Krimi kundër njerëzimit i vrasjes së  
15 paligjshme i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(a) të Ligjit;  
16 dhe

17 ix. Pika 9: Krimi i luftës i vrasjes së paligjshme i  
18 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit.

19 2. Krimet në pikat 1, 2, 4, 6, 8 dhe 10 u kryen si pjesë  
20 e sulmit gjerësisht të përhapur ose sistematik kundër  
21 popullatës civile në Kosovë dhe në Shqipërinë Veriore së paku  
22 që prej marsit 1998 deri në shtator 1999. Në veçanti, këto  
23 krime vunë në shënjestër "kundërshtarët", që konsideroheshin  
24 se kishin qenë bashkëpunëtorë ose të lidhur me forca zyrtare  
25 ose institucione shtetërore të Republikës Federative të

1 Jugosllavisë ("RFJ") ose ndryshe nuk mbështesnin qëllimet ose  
2 metodat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe më vonë  
3 të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, ndër të cilët persona të  
4 lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe me serbë, romë  
5 dhe persona të kombësive të tjera.

6 3. Krimet në pikat 3, 5, 7, dhe 9 u kryen kundër  
7 personave që nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kontekstin  
8 e konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar dhe në lidhje me  
9 këtë konflikt ndërmjet UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe të  
10 Republikës së Serbisë, ndër të cilat, njësite të ushtrisë  
11 Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të  
12 Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe grupe të tjera që  
13 luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë që prej më së paku  
14 marsit 1998 deri afërsisht 16 shtator 1999.

15 4. Në lidhje me këto krime, ekziston një dyshim i bazuar  
16 mirë se z. Veseli ka përgjegjësi penale në bazë të nenit  
17 16(1) (a) të Ligjit për:

18 a. Kryerje, si anëtar i ndërmarrjes kriminale të  
19 përbashkët, të krimeve në pikat 1-10, ose si alternativë për  
20 kryerjen, si anëtar i ndërmarrjes kriminale të përbashkët të  
21 sipërpërmendur, për krimet në pikat 1-10, duke pasur dijeninë  
22 se krime të tilla mund të kryheshin në zbatim të qëllimit të  
23 përbashkët të ndërmarrjes kriminale të përbashkët dhe duke  
24 marrë përsipër atë rrezik me vullnet të lirë; dhe/ose

25 b. Për ndihmë dhe inkurajimin e krimeve në pikat 1-10.



1 5. Gjithashtu dhe si alternativë ekziston dyshim i bazuar  
2 mirë se z. Veseli ka përgjegjësi penale në bazë të nenit  
3 16(1)(c) të Ligjit si epror për krimet në pikat 1-10.

4 Ju faleminderit, i nderuar Gjykatës.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

6 Sekretare.

7 Z. Veseli unë dua t'ju kujtoj se tani nuk është momenti  
8 për t'i kundërshtuar akuzat, por thjesht për të konfirmuar se  
9 i kuptoni akuzat e reja. Do të keni mundësi të bollshme që t'i  
10 kundërshtoni këto akuza me ndihmën e mbrojtësit tuaj.

11 Z. Veseli, a i kuptuat akuzat e reja të përfshira në  
12 aktakuzën e konfirmuar ashtu sikurse ua lexoi Sekretarja e  
13 sallës së Gjyqit?

14 I AKUZUARI VESELI: [Përmes videolidhjes] Faleminderit, z.  
15 Gjykatës. I kam lexuar dhe kam dëshirë që procesi gjyqësor të  
16 fillojë sa më shpejt dhe të kem të drejtën time të shpreh  
17 pozitën time dhe pafajësinë time para qytetarëve të Republikës  
18 së Kosovës, luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë edhe  
19 këtij gjyqi të nderuar.

20 Faleminderit shumë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Veseli.

22 Tani t'ju kujtoj të drejtat tuaja që keni para kësaj  
23 Gjykate.

24 Ligji u garanton disa të drejta dhe unë do t'ua lexoj më  
25 të rëndësishmet.

1 E para, prezumoheni i pafajshëm deri në vërtetimin e  
2 fajësisë tuaj përtej dyshimit të arsyeshëm.

3 Marrjen e vendimit mbi akuzat kundër jush keni të drejtën  
4 e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë në vartësi të masave të  
5 urdhëruara për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

6 Keni të drejtën të informoheni në kohë dhe në hollësi në  
7 një gjuhë që ju e kuptoni dhe flini për natyrën dhe shkakun e  
8 akuzave kundër jush.

9 Keni të drejtën për të pasur kohë dhe mundësi e mjete të  
10 mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes si edhe për të  
11 komunikuar me avokatin mbrojtës që keni zgjedhur vetë.

12 Keni të drejtën që të gjykoheni brenda një periudhe  
13 kohore të arsyeshme.

14 Keni të drejtë që të gjykoheni në praninë tuaj dhe të  
15 mbroheni nëpërmjet avokatit tuaj të mbrojtjes.

16 Keni të drejtën që t'ju caktohet një avokat mbrojtës edhe  
17 atë pa pagesë në qoftë se nuk dispononi mjete të mjaftueshme  
18 për pagesën e mbrojtjes.

19 Keni të drejtë që t'u bëni pyetje ose dikush tjetër t'u  
20 bëjë pyetje në emrin tuaj dëshmitarëve si dhe të kërkon  
21 praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emrin tuaj.

22 Keni të drejtën e ndihmës së një përkthyesi falas nëse  
23 nuk e kuptoni dhe flisni gjuhën që përdoret në Gjykatë.

24 Keni të drejtë që të mos detyroheni të dëshmoni kundër  
25 vetes apo të pranoni fajësinë.

1 Keni të drejtë të qëndroni i heshtur dhe nuk do të  
2 nxirret asnjë përfundim negativ nga heshtja juaj.

3 Gjithashtu, keni të drejtën të bëni deklaratë pa betim në  
4 lidhje me çështjen kundër jush dhe mund të paraqiteni  
5 gjithashtu edhe si dëshmitar nën betim.

6 Keni të drejtë të paraqisni mocione paraprake.

7 Keni të drejtë që t'i merrni materialet mbështetëse të  
8 aktakuzës së ndryshuar të dorëzuar për konfirmim.

9 Keni të drejtë të merrni të gjitha deklaratat e  
10 dëshmitarëve që ZPS-ja synon t'i ftojë të dëshmojnë në gjyq në  
11 gjuhën që e kuptoni dhe e flisni.

12 Gjithashtu, keni të drejtë që menjëherë të merrni çfarëdo  
13 informacioni që mund të sugjerojë pafajësinë tuaj apo të zbusë  
14 fajësinë tuaj apo të cilat ndikojnë në kredibilitetin apo  
15 besueshmërinë e provave të Prokurorit menjëherë sapo ky  
16 informacion të jetë nën kontrollin apo ruajtjen e Dhomave -- e  
17 Prokurorit.

18 Keni të drejtë të gjitha materialet dhe provat që ka  
19 Prokurori t'ju jepin përpara fillimit të procedurës. Kjo është  
20 e drejtë që kufizohet vetëm me masat kompensuese në fuqi.

21 Keni të drejtë që të mos mbaheni në paraburgim për një  
22 periudhë të paarsyeshme para fillimit të çështjes tuaj. Të  
23 kërkoni rishikimin e vendimeve në lidhje me paraburgimin dhe  
24 t'i apeloni ato.

25 Dhe së fundi, keni të drejtë që të apeloni, qoftë

1 drejtpërdrejtë apo nëpërmjet procesit të konfirmimit sikurse  
2 parashikohet në Rregullore.

3 Z. Veseli, dëgjuat të drejtat më të rëndësishme që janë  
4 paraparë në kuadrin ligjor të Dhomave të Specializuara të  
5 Kosovës. A i keni të qarta këto të drejta?

6 I AKUZUARI VESELI: [Përmes videolidhjes] I nderuari z.  
7 Gjyqtar, ju falënderoj për të gjitha këto të drejta. Dhe kisha  
8 pasë dëshirë që këto të drejta të cilat i përmendni të kenë të  
9 drejtë pikërisht në këtë Gjykatë dhe t'i aplikojë.

10 Faleminderit shumë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Këto janë të drejtat që  
12 zbatohen përpara kësaj Gjykate.

13 Z. Veseli dua që t'ju përkujtoj se sipas nenit 21(5) të  
14 Ligjit ju nuk mund të vetëpërfaqësoheni sepse jeni në  
15 paraburgim dhe prandaj pasja e një mbrojtësi është e  
16 domosdoshme. E shoh që jeni i përfaqësuar prej mbrojtësit dhe  
17 keni qenë i përfaqësuar që nga fillimi i procedurave. Dhe me  
18 këtë jam i bindur se i akuzuari është përfaqësuar nga një  
19 mbrojtës.

20 Tani do të flas për mundësinë që i akuzuari të  
21 vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë.

22 Z. Veseli, brenda 30 ditësh nga seanca e sotme do të  
23 ftoheni që të vetëdeklaroheni fajtor ose i pafajshëm në lidhje  
24 me të gjitha akuzat e reja të përfshira në aktakuzën e  
25 ndryshuar të konfirmuar. Në qoftë se dëshironi, mund këtë ta

1 bëni edhe sot.

2 Prandaj, po ju pyes z. Veseli në qoftë se keni pasur  
3 mundësi që t'i diskutoni akuzat e reja të përfshira në  
4 aktakuzën e konfirmuar me avokatin tuaj mbrojtës dhe nëse jeni  
5 i gatshëm që të vetëdeklaroheni në lidhje me këto në këtë  
6 seancë, pra sot.

7 Urdhëro, z. Veseli.

8 I AKUZUARI VESELI: [Përmes videolidhjes] Deklarohem i  
9 pafajshëm

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Veseli. E  
11 kam marrë këtë shënim.

12 Gjithashtu do t'ju kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve tani  
13 që të na thonë në qoftë se kanë ndonjë gjë tjetër për të  
14 ngritur.

15 Fillojmë me ZPS-në.

16 Z. TIEGER: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të ngritur.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Laws

18 Z. LAWS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo, nuk kemi  
19 asgjë për të ngritur.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe tani po i kthehem  
21 Mbrojtjes.

22 Z. Emmerson.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Asgjë për  
24 këtë moment, por çështjet që kemi për t'i ngritur do t'i  
25 ngremë në seancën për ecurinë e çështjes në vijim.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani shkurtimisht do ta jap  
2 një urdhër të shkurtër me gojë në lidhje afatet që kanë të  
3 bëjnë me kërkesën e Mbrojtjes për rishqyrtimin e lejes për  
4 apel të z. Veseli që është parashtrimi F796.

5 Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë që kam parashtruar  
6 të vendimin tim të 2 majit, urdhëroj ZPS-në që t'i përgjigjet  
7 kërkesës së Veselit që është parashtrimi me numër F796 deri të  
8 hënën, 23 maj 2022.

9 Përveç kësaj, theksoj se e kam ndryshuar afatin në  
10 përputhje me rregullin 9 të Rregullores për vendimin në lidhje  
11 me kërkesën për leje për apel dhe për parashtrime të tjera të  
12 palëve në lidhje me këtë çështje.

13 Kaq -- këtu përfundon urdhri im gojor.

14 Këtu përfundon edhe seanca e sotme. I falënderoj palët  
15 dhe pjesëmarrësit. Mbyllet këtu seanca.

16 --- Paraqitja e mëtejshme përfundon në orën  
17 11.37

18

19

20

21

22

23

24

25